



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.121/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.121/2026, të datës 02.02.2026, të parashtruar nga ankuesit: F.H, R.M, M.M, M.R, N.K, XH.B, G.B, B.S, O.G, Z.M dhe B.Z, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokate Argjira Asllani, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 01.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.121/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga ankuesit F.H, R.M, M.M, M.R, N.K, XH.B, G.B, B.S, O.G, Z.M, B.Z.

A r s y e t i m

Ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi, përmes përfaqësueses së tyre të autorizuar, me datë 02.02.2026, kanë parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative dhe moszbatimit të së drejtës në shtesën e përvojës së punës, ndaj kërkesës me numër protokolli 3150 të datës 17.11.2025, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar* Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit më 18.02.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*), për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 555/2026 të datës 02.02.2026; Autorizimet e ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.02.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 19.02.2026; Kërkesën nga ankuesit me date 23.01.2026; kërkesën e ankuesve nga organi i punësimit me date 17.11.2025; Akt emërimin për F.H të datës 20.08.2025; Akt emërimin për R.M të datës 20.08.2025; Akt

emërimin për M.M të datës 20.08.2025; Akt emërimin për M.R të datës 20.08.2025; Akt emërimin për N.K të datës 20.08.2025; Akt emërimin për XH.B të datës 20.08.2025; Akt emërimin për G.D të datës 20.08.2025; Akt emërimin për B.S të datës 20.08.2025; Akt emërimin për O.G të datës 20.08.2025; Akt emërimin për Z.M të datës 20.08.2025; Akt emërimin për B.Z të datës 20.08.2025; Planet individuale vjetore për pozitat e ankuesve për vitin 2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve, **është e pabazuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i provave të administruara të lëndës konstaton se ankuesit posedojnë Akte të Emërimit dhe rrjedhimisht të gjithë kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, dhe janë të punësuar në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Si rrjedhojë, ankuesit më datë 17.11.2025 kanë parashtruar Kërkesën me numër protokolli 3150 tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes të cilës kanë kërkuar zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO79/23 lidhur me shtesën për përvojën e punës dhe kompensimit të dëmit në mënyrë retroaktive nga 0.25% në 0.50 %, prej ditës së hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nga muaji Shkurt 2023 deri në muajin Qershor 2025, për gjithsejtë 28 muaj. Ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit nuk kanë pranuar përgjigje ndaj kësaj kërke.

Ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative dhe moszbatimit të së drejtës në shtesën e përvojës së punës nga organi përkatës i punësimit, andaj kërkojnë aprovimin në tërësi si të bazuar të ankesës, njohjen e të drejtës së përvojës së punës me 0.5 % të Ligjit si dhe kompensimit në mënyrë retroaktive të vlerës së dëmit për përvojën e punës nga 0.25% në 0.5% prej ditës së hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, e deri në muajin Qershor 2025, për gjithsejtë 28 muaj.

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”,* dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç ‘rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja jo proporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të*

pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafi 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas interpretimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj në meritë pretendimet ankimore lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë, kështu që, pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër: A.nr.121/2026

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësueses së autorizuar të ankuesve, Avokates Argjira Asllani;*
- *Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;*
dhe;
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*